



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:086677
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05496701
P.nr.150/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit B.A nga Prishtina, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 paragrafi 1 i KPRK-ës, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm për dhënien e urdhrit ndëshkimor me numër PP.II.nr.379/2024, të datës 13.03.2024, pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me datë 25.03.2024, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhrit ndëshkimor me numër PP.II.nr.379/2024, e datës 13.03.2024, ndaj të pandehurit B.A, nga babai H dhe nëna E, e lindur K, i lindur me datënë Prishtinë ku edhe jeton, ..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion mekanik, i shkukurëzuar, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, identifikuar me numër personal...., i cili

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 13.02.2023, rreth orës 00:00 h, në Gjilan, në rrugën ...më saktësisht në pompën e derivateve të naftës ...me qëllim të shkakimit të frikësimit dhe të ankthit, ka kanosur seriozisht të dëmtuarin A.K, ashtu që me automjetin e tij të markës “..”, me tabela të regjistrimit...., ndalet tek pompa e derivateve, hynë në market, e kanos të dëmtuarin me fjalë ”Veq mos dalësh hiq nga këtu , kam me ta thye kokën...”, dhe vazhdon tek punëtori tjetër i këtij marketi të cilit i kërkon numrin e telefonit të dëmtuarit, duke i thënë “Se kam punë me këtë person...”, kështu që i pandehuri me veprimet e veta tek i dëmtuari ka shkakuar frikë , ankth dhe shqetësim të madh emocional.

- Me çka ka kryer veprën penale kanosja nga neni 181 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së si dhe nenit 495 të KPP-së të pandehurin e lartcekur:

E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 250 € (dyqindpesëdhjetë euro) të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

I dëmtuari A.K për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzetë euro) si dhe shumën prej 20 € (njëzetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 12.03.2024, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.379/2024, kundër të pandehurit B.A nga Prishtina, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 paragrafi 1 i KPRK-ës dhe njëherit gjykatës i ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimit dhe shqiptimin e dënimit me gjobë për të pandehurin me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 të KPP-ës.

Gjykata pas shikimit dhe analizimit të aktakuzës lëndore dhe shkresave të lëndës së bashku me kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimit gjeti se në këtë çështje penalo juridike janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-së për dhënien e urdhrin ndëshkimit dhe konform nenit 495 paragrafi 1, 2 dhe 3 të KPP-së vendosi që të pranojë kërkesën e lartcekur dhe të pandehurit ti shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë si dhe provat e bashkangjitura në të ofrojnë bazë të mjaftueshme për një gjë të tillë dhe deri tek një konstatim i tillë gjykata erdhi duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2023-CA-204, i datës 04.03.2024, deklarata e të dëmtuarit A.K, deklarata e dëshmitarit M.R, deklarata e të pandehurit B.A, raporti i zyrtarit policor, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes si dhe shkresat e tjera të bashkangjitura në lëndë dhe rrjedhimisht bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë ashtu siç është propozuar nga prokurori i shtetit në kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimit mund të arrihen qëllimet e dënimit nga neni 38 i KPRK-ës.

Gjykata bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP-ës, të dëmtuarin A.K për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

Gjithashtu duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro) si shumën prej 20 € (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në bazë të nenit 495 paragrafi 1, 2 dhe 3 të KPP-ës gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i përgjithshëm

P.nr.150/2024, me datë 25.03.2024

Zyrtarja ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermahaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve.